

Pasqyrat Financiare

CORAL ALBANIA Sha

31 Dhjetor 2018

Përmbajtja


	Faqe
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	7
DEKLARATA E HARTUESIT TË PASQYRAVE FINANCIARE	27


Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2018
(në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 Dhjetor 2018
AKTIVET		
Mjetet monetare dhe ekuivalente	4	6,448,000
Të tjera të drejta të arkëtueshme	5	30,163
Totali i aktiveve afatshkurtra		6,478,163
Aktive afatgjata jo materiale, neto	6	11,417,996
Totali i aktiveve afatgjata		11,417,996
TOTALI I AKTIVEVE		17,896,159
DETYRIMET DHE KAPITALI		
Llogari e kërkesa të pagueshme	7	11,634,063
Sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të pagueshme	8	21,305
Të tjera të pagueshme	9	3,500
Totali i detyrimeve afatshkurtra		11,658,868
Totali i detyrimeve afatgjata		-
Totali i detyrimeve		11,658,868
Kapitali i regjistruar		6,300,000
Fitimi (Humbja) i/e akumuluar		-62,709
Totali i kapitalit	12	6,237,291
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		17,896,159

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë 25 Mars 2019 dhe firmosur në emër të saj nga:


Ilias Papadimitriou ;
Administrator


Prodromos Tastsoglou
Administrator



Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2018
(në Lek)

Pasqyra e Performancës

	Shënime	31 Dhjetor 2018
Të Ardhura		
Shitje shërbime	13	-
Të ardhurat totale		<u>-</u>
Kostot operative		
Shpenzime për personelin	14	-21,305
Zhvlerësim dhe amortizim	6	-
Shpenzime administrative dhe të tjera	15	-154,316
Totali i shpenzimeve operative		<u><u>-175,621</u></u>
Fitimi/(humbja) neto nga operacionet		<u><u>-175,621</u></u>
Totali i të ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	16	112,913
Fitimi (humbja) para tatimit		<u><u>-62,709</u></u>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	17	-
Fitim (humbja) për vitin		<u><u>-62,709</u></u>

Shih shenimet shpjeguese që janë pjesë perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2018
(në Lek)

Pasqyra e Flukseve Monetare

	Shënime	31 Dhjetor 2018
Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytezimit		
Fitimi (humbja) para tatim fitimit		-62,709
Fitimi nga veprimtaritë e shfrytezimit para rregullimeve në kapitalin punues		-62,709
(Rritje) / ulje e llogarive të arkëtueshme dhe të tjera		-30,163
Rritje / (ulje) në furnitorë dhe të tjera detyrime		11,658,868
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		11,565,996
Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		11,565,996
Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit		
Blerje aktivesh afat-gjata materiale	6	-11,417,996
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (përdorur në) veprimtaritë e investimit		-11,417,996
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare		
Rritja e kapitalit		6,300,000
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (përdorur në) veprimtaritë financiare		6,300,000
Rritja/(ulja) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente		6,448,000
Mjete monetare dhe ekuivalente më 1 Janar		-
Mjete monetare dhe ekuivalente më 31 Dhjetor	4	6,448,000

Shih shenimet shpjeguese që janë pjesë perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2018
(në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i Regjistruar	Fitimi (humbje) periudhës	Totali
Gjendja më 01 Janar 2018	-	-	-
Rritja e kapitalit	6,300,000	-	6,300,000
Fitimi (humbje) periudhës	-	-62,709	-62,709
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	6,300,000	-62,709	6,237,291

Shih shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

Shënimet e Pasqyrave Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Coral Albania Sha ("Shoqëria") është një shoqëri aksionere, e themeluar dhe krijuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më 14 Nëntor 2018. Selia e shoqërisë është në "Reshit Çollaku", Shk.4, Ap.44, Tiranë, Shqipëri. Shoqëria është regjistruar pranë autoriteteve fiskale me Numër Identifikimi të Personit të Tatuashëm (NIPT) L82314029E.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë do të jetë Import-Eksport, shitje me shumice dhe pakicë i karburantit, gazit dhe cdo lloj aktiviteti tjetër në përputhje me ligjin dhe që i shërben operacioneve të mësipërme. Gjatë vitit 2018, shoqëria nuk kishte aktivitet.

Administrator të Shoqërisë janë : Z. Ilias Papadimitriou dhe Z. Prodromos Tastsoglou. Më 31 Dhjetor 2018 shoqëria kishte 2 (dy) punonjës (31 Dhjetor 2017: 0 punonjës).

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 25 Mars 2019.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Politikat kryesore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e pasqyrave financiare, janë në përputhje me Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike. Monedha e raportimit është Leku Shqiptar ("Lek") që është gjithashtu edhe monedha funksionale.

Shoqëria mban librat e saj kontabel dhe publikon pasqyrat e saj statutores financiare në përputhje me Ligjin e Kontabilitetit Nr. 9228 date 29 prill 2008 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat e saj financiare në përputhje me SNRF, të cilat u bene të detyrueshem në Shqipëri në baze të vendimit të Ministrisë së Financave Nr. 65, dt. 05.05.2008, "Per publikimin dhe zbatimin e detyrueshem të standardeve nderkombetare të kontabilitetit dhe standardeve nderkombetare të raportimit financiar, të perkthyer në gjuhën shqipe".

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare netohen kundrejt njëra tjetres dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një drejtë ligjeshme e zbatueshme për të netuar shumat e njohura dhe ka qellim shlyerjen e tyre mbi baze neto, ose të realizojë aktivitetet dhe të shlyejë detyrimet në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk netohen në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve, përveç nëse kerkohet ose lejohet nga standardet e kontabilitetit ose interpretimet e tyre, dhe sic parashikohet në mënyrë specifike në politikat kontabel të shoqërisë.

2.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive ne periudhen aktuale

Politikat kontabel te adoptuara jane konsistente me politikat e vitit te meparshem me perjashtim te SNRF-ve te ndryshuara, te cilat jane adoptuar nga Shoqeria ne daten 1 janar 2018:

- **SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët**
- **SNRF 9 Instrumentet Financiare - Klasifikimi dhe matja**
- **KIRFN 22 Interpretim - Transaksionet dhe Paradhënia në Monedhë të Huaj**
- **Transferimet e Aktiveve afatgjata materiale të investuara – Ndryshimet në SNK 40**
- **SNRF 2 – Klasifikimi dhe matja e Transaksioneve të “Pagesave të bazuara në aksione” — Ndryshime në SNRF 2**
- **Ndryshimet në SNRF 4 - Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet financiare me SNRF 4 Kontratat e sigurimit**
- **SNK 28 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta - Sqarim se matja e te investuarve me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është një zgjedhje specifike për cdo investim.**
- **SNRF 1 - Adoptimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar për herë të parë - heqja e përjashtimeve afatshkurtra për adoptuesit e parë**

Megjithese keto standarde dhe ndryshime te reja jane aplikuar per here te pare duke filluar nga 1 Janar 2018, ato nuk kane patur impakt material ne pasqyrat financiare vjetore te Shoqerise. Natyra dhe ndikimi i cdo standardi dhe ndryshimi eshte pershkruar si vijon:

- **SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët**
Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018. SNRF 15 përcakton një model me pesë-hapa që do të aplikohet për të ardhurat e fituara nga një kontratë me klientin (me përjashtime të kufizuara), pavarësisht nga lloji i transaksionit të të ardhurave apo industrisë. Kërkesat e standardit do të aplikohen gjithashtu për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve mbi shitjen e disa aktiveve financiare që nuk janë një prodhim i veprimtarive të zakonshme të njësisë (p.sh., shitja e pronës, e pajisjeve apo aktiveve të paprekshme). Dhënia e gjerë e informacioneve shpjeguese do të jetë e nevojshme, përfshirë ndarjen e të ardhurave totale; informacionin mbi detyrimet e performancës, ndryshimet në balancat e llogaritjeve të aktiveve dhe detyrimeve të kontratës ndërmjet periudhave, si dhe gjykimet dhe vleresimet kryesore. Aplikimi i këtij standardi nuk ka ndonjë efekt në pasqyrat financiare të Shoqerisë.
- **SNRF 9 Instrumentet Financiare - Klasifikimi dhe matja**
Standardi aplikohet për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018 por lejohet adoptimi i hershëm. Faza perfundimtare e SNRF 9 pasqyron të gjitha fazat e projektit të instrumenteve financiare dhe zëvendëson SNK 39 Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja dhe të gjithë versionet e mëparshme të SNRF 9. Standardi prezanton kërkesa të reja për klasifikimin dhe matjen, zhvlerësimin dhe kontabilitetin e instrumentave mbrojtës. Aplikimi i standardit nuk ka efekt material në pasqyrat financiare të Shoqerisë. Adoptimi i IFRS 9 e ka ndryshuar rrenjesisht kontabilitetin e Shoqerise ne lidhje me zhvleresimet e asetve financiare duke zevendesuar modelin e humbjeve te ndodhura te IAS 39 me modelin e humbjeve te pritshme (ECL). Aplikimi i këtij standardi nuk pati ndonjë efekt material në pasqyrat financiare të Shoqerisë për shkak të krijimit të saj gjatë viti 2018.
- **KIRFN 22 Interpretim - Transaksionet dhe Paradhënia në Monedhë të Huaj**
Interpretimi sqaron se, në përcaktimin e kursit të këmbimit të castit për t'u përdorur në njohjen fillestare të aktivitetit, shpenzimeve ose të ardhurave (ose një pjese të tij) në c'registrimin e një aktiviteti jo-monetar ose detyrimi jo-monetar që lidhet me paradhënien, data e transaksionit është data në të cilën njësisia ekonomike fillimisht njihet aktivitetin jo-monetar ose detyrimin jo-monetar që rrjedh nga parapagimi. Nëse ka disa pagesa ose arkëtime në avancë, atëherë njësisia ekonomike duhet të përcaktojë datën e transaksionit për secilën pagesë ose arkëtim në avancë lidhur me paradhënien. Njësitë duhet të aplikojnë ndryshimet në bazë të plotë retrospektive.

2.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive ne periudhen aktuale (vazhdim)

Ne menyre alternative, një njësi ekonomike mund të zbatojë Interpretimin në mënyrë prospektive për të gjitha aktivet, shpenzimet dhe të ardhurat brenda objektivit të interpretimit që njihen fillimisht më ose pas:

- (i) Fillimit të periudhës raportuese në të cilën njësi ekonomike e zbaton interpretimin për herë të pare ose
- (ii) Fillimit të periudhës raportuese paraprake të paraqitur si informacion krahasues në pasqyrat financiare të periudhës raportuese në të cilën njësi ekonomike zbaton interpretimin për herë të parë.

Aplikimi i interpretimit nuk ka efekt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **Transferimet e Aktiveve afatgjata materiale të investuara – Ndryshimet në SNK 40**

Ndryshimet sqarojnë kur një njësi ekonomike duhet të transferojë aktivet afatgjata materiale, duke përfshirë ato në ndërtim ne Aktive afatgjata materiale te investuara, ose e kunderta. Ndryshimet theksojnë se një ndryshim në përdorim ndodh kur prona përmbush, ose pushon së përmbushuri, përkufizimin e aktivitet afatgjate material të investuar dhe ka prova të këtij ndryshimi në përdorim. Në veçanti, një ndryshim në qëllimet e drejtimit për përdorimin e një prone nuk përbën provë të një ndryshimi në përdorim. Subjektet duhet të zbatojnë ndryshimet në mënyrë prospektive për ndryshimet në përdorim që ndodhin në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësi ekonomike i zbaton ndryshimet e standardit për herë të parë. Një njësi ekonomike duhet të rivlerësojë klasifikimin e pasurive të mbajtura në atë datë dhe, nëse është e aplikueshme të bëjë riklasifikimin e pronës për të pasqyruar kushtet që ekzistojnë në atë datë. Zbatimi retrospektiv lejohet vetëm nëse është në përputhje me SNK 8. Aplikimi më herët është i lejuar dhe duhet paraqitur ne shënime shpjeguese në pasqyrat e Shoqërisë. Keto amendime nuk kane impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **SNRF 2 – Klasifikimi dhe matja e Transaksioneve të “Pagesave të bazuara në aksione” — Ndryshime në SNRF 2**

BSNK publikoi ndryshime në SNRF 2 Pagesat e bazuara në aksione që adreson këto tre fusha: efektet e “konditave të kushtëzimit” mbi matjen e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione të shlyera me mjete monetare; klasifikimin e transaksioneve të pagesave bazuar në aksione me kushte për shlyerje të detyrimeve të tatimit në burim; dhe kontabilizimin kur një modifikim i kushteve dhe termave të pagesave bazuar në aksione ndryshon klasifikimin nga të pagueshme me mjete monetare në të pagueshme me kapital. Njësitë kërkohet të aplikojnë ndryshimet pa riparaqitur periudhat e mëparshme, por aplikimi retrospektiv është i lejuar nese behet për të tre ndryshimet dhe nese plotësohen edhe kriteret e tjera. Keto amendime nuk kane impakt material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **Ndryshimet në SNRF 4 - Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet financiare me SNRF 4 Kontratat e sigurimit**

Ndryshimet adresojnë shqetësimet që dalin nga zbatimi i standardit të ri të instrumenteve financiare, SNRF 9, përpara zbatimit të SNRF 17 Kontratat e sigurimit, i cili zëvendëson SNRF 4. Ndryshimet prezantojnë dy opsione për subjektet që lëshojnë kontrata sigurimi: një përjashtim i përkohshëm nga zbatimi i SNRF 9 dhe një metodë mbivendosjeje. Një njësi ekonomike mund të zgjedhë metodën e mbivendosjes kur ajo së pari zbaton SNRF 9 dhe e zbaton këtë qasje në mënyrë retrospektive ndaj aktiveve financiare të përcaktuara në tranzicion në SNRF 9. Njësi ekonomike rishikon informacionin krahasues që pasqyron qasjen mbivendosëse nëse dhe vetëm nëse njësi ekonomike rishikon informacionin krahasues gjatë zbatimit të SNRF 9. Këto ndryshime nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë.

2.1 Standarde, interpretime dhe amendime efektive ne periudhen aktuale (vazhdim)

- **SNK 28 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarje të përbashkëta - Sqarim se matja e e te investuarve me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është një zgjedhje specifike për cdo investim.**

Ndryshimet sqarojnë se:

- Një njësi ekonomike që është një organizatë sipërmarjeje kapitalesh, ose një njësi tjetër që kualifikohet, mund të zgjedhë që në njohjen fillestare per secilin investim te saj vec e vec, të masë investimet e saj në pjesëmarrje dhe sipërmarje të përbashkëta me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.
- Nëse një njësi ekonomike, që nuk është në vetvete një njësi ekonomike investuese, ka një interes në një pjesëmarrje ose sipërmarje të përbashkët që është një njësi ekonomike investuese, njësia ekonomike, në zbatimin e metodës së kapitalit neto, mund të zgjedhë të mbajë te njëjtën vlerë të drejtë të zbatuar nga njësia ekonomike investuese në interesat e saj në filiale. Këto zgjedhje bëhen veçmas për secilën njësi ekonomike investuese pjesemarrje ose sipërmarjeje e perbashket, ne daten më të vonshme ne te cilen:
 - (a) njësia ekonomike investuese ose ndërmarrja e përbashkët njihet fillimisht;
 - (b) shoqëria ose ndërmarrja e përbashkët bëhet një njësi ekonomike investuese; apo
 - (c) shoqëria e investimit ose pjesëmarrja e përbashkët bëhet Shoqëri meme per here te pare.

Keto amendime nuk janë të aplikueshme për Shoqërisë.

- **SNRF 1 - Adoptimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar për herë të parë - heqja e përjashtimeve afatshkurtra për adoptuesit e parë**

Përjashtimet afatshkurtra në paragrafët E3-E7 të SNRF 1 u fshinë sepse qellimi i tyre është realizuar. Ky ndryshim nuk është i zbatueshëm për Shoqërinë.

2.2 Standarte te emetuara por qe ende nuk kane hyre ne fuqi dhe nuk jane adoptuar

Standardet dhe interpretimet e emetuara, por që nuk kanë hyrë ende në fuqi, deri në datën e deklarimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë, janë pasqyruar më poshtë. Shoqëria synon të adoptojë këto standarde, nëse janë të aplikueshme, kur ato të bëhen efektive.

- **SNRF 16 – Qiratë**

BSNK publikoi standardin e ri për kontabilizimin e qirave - SNRF 16 Qiratë në Janar 2016. Standardi i ri nuk ndryshon shumë kontabilizimin e qirave nga qiradhënesit. Megjithatë, kërkon që qiramarrësit të njohin në bilancin e tyre kontabël të gjitha qiratë si detyrime si dhe aktivet koresponduesesë. Qiramarrësit duhet të përdorin një model të vetëm për njohjen e të gjitha qirave, por do të kenë opsionin të mos njohin qiratë afatshkurtra ose qiratë për aktive me vlera të vogla. Në përgjithësi, modeli i njohjes do jetë i ngjashëm me atë që përdoret aktualisht për kontabilizimin e qirave financiare, me interesin dhe shpenzimin e amortizimit të njohur në zëra të vecantë në pasqyrën së fitimit ose humbjes. SNRF 16 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2019. Aplikimi më herëshëm është i lejuar nëse standardi i ri i të ardhurave, SNRF 15 aplikohet në të njëjtën datë. Qiramarrësit duhet të adoptojnë SNRF 16 duke përdorur ose metodën e plotë retrospektive ose metodën e modifikuar retrospektive. Shoqëria nuk synon të aplikojë këtë standart përpara hyrjes së tij në fuqi dhe po vlerëson ndikimin e mundshëm të tij.

- **SNRF 17 Kontratat e sigurimit**

Në Maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (SNRF17), një standard i ri kontabël gjithpërfshirës për kontratat e sigurimeve që mbulon njohjen dhe matjen, prezantimin dhe shënime shpjeguese. Pasi të bëhet efektiv, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4) që është nxjerrë në vitin 2005. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth., jetë, jo-jetë, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi), pavarësisht nga lloji i subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe për disa garanci dhe instrumente financiare me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionare. Do të ketë disa përjashtime nga objekti.

2.2 Standarte te emetuara por qe ende nuk kane hyre ne fuqi dhe nuk jane adoptuar (vazhdim)

Objektivi i përgjithshëm i SNRF 17 është të sigurojë një model kontabiliteti për kontratat e sigurimit që të jetë më i dobishëm dhe i qëndrueshëm për siguruesit. Në kontrast me kërkesat e SNRF 4, të cilat bazohen kryesisht në politikat e mëparshme të kontabilitetit, SNRF 17 ofron një model gjithëpërfshirës për kontratat e sigurimeve, duke mbuluar të gjitha aspektet përkatëse të kontabilitetit. SNRF 17 hyn në fuqi për periudhat që fillojnë më ose pas 1 Janar 2021 dhe zbatimi i tij kërkon paraqitjen e vlerave krahasuese të periudhave të mëparshme. Aplikimi i më hershëm është i lejueshëm me kusht që Shoqëria të aplikojë SNRF 9 dhe SNRF 15 më ose përpara datës së aplikimit të SNRF 17. Ky standard nuk është i aplikueshëm për Shoqërinë.

- KIRFN 23 Interpretimi - Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit Mbi te Ardhurat

Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasiguri që ndikojnë në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushëveprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesa lidhur me interesa dhe penalitete që lidhen me trajtimin e pasigurt tatimor.

Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një njësi ekonomike i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veç e veç.
- Supozimet që një njësi ekonomike bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore
- Si një njësi ekonomike përcakton fitimin e tatueshëm (humbje tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore
- Si një njësi ekonomike i konsideron ndryshimet në fakte dhe rrethana.

Një njësi ekonomike duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore. Duhet të ndiqet qasja që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Interpretimi është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019, por janë të disponueshme disa lehtësime të tranzicionit. Kompania nuk parashikon adoptimin e hershëm të interpretimit dhe aktualisht po vlerëson ndikimin e tij.

- Ndryshime te SNRF 9: Elemente parapagimi me kompensim negativ

Sipas SNRF 9, një instrument borxhi mund të matet me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, me kusht që flukset monetare kontraktuale të jenë “vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të mbetur” (kriteri i SPPI) dhe instrumenti mbahet brenda nje model biznesi te përshtatshëm për këtë klasifikim. Ndryshimet në SNRF 9 sqarojnë se një aktiv financiar kalon kriterin e SPPI pavarësisht nga ngjarja ose rrethana që shkakton ndërprerjen e parakohshme të kontratës dhe pavarësisht se cila pale paguan ose merr kompensim të arsyeshëm për përfundimin e parakohshëm të kontratës. Ndryshimet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive dhe hynë në fuqi që nga 1 janari 2019, aplikimi i më hershëm është i lejueshëm. Këto ndryshime nuk pritet të kenë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja ose kontributi i Aktiveve nga investitori tek pjesëmarrja e tij ose sipërmarrja e përbashkët

Ndryshimet adresojnë konfliktin midis SNRF 10 dhe SNK 28 për trajtimin e humbjes së kontrollit mbi një filial që shitet ose kontribuohet tek një pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët. Ndryshimet sqarojnë se fitimi ose humbja që rezulton nga shitja ose kontributi i aktiveve që përbëjnë një biznes, siç përcaktohet në SNRF 3, nga investitori tek pjesëmarrja e tij ose sipërmarrja e përbashkët, njihet plotësisht. Çdo fitim ose humbje që rezulton nga shitja ose kontributi i aktiveve që nuk përbëjnë një biznes, njihet vetëm në masën e interesave të investitorëve të palidhur në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët. BSNK ka shtyrë datën efektive të këtyre ndryshimeve për një kohë të pacaktuar, por një njësi ekonomike që i aplikon

Shënime të pasqyrat financiare (vazhdim)
Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

ndryshimet me heret duhet t'i zbatojë ato në mënyrë prospektive. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

2.2 Standarte te emetuara por qe ende nuk kane hyre ne fuqi dhe nuk jane adoptuar (vazhdim)

- **Ndryshimet në SNK 19: Amendamenti, Kufizimet, ose Shlyerja e Planit**

Ndryshimet në SNK 19 adresojnë kontabilitetin kur një ndryshim, kufizim ose shlyerje plani ndodh gjatë një periudhe raportuese. Ndryshimet specifikojnë se kur një ndryshim, kufizim ose shlyerje plani ndodh gjatë periudhës raportuese vjetore, një njësi ekonomike duhet të:

- Përcaktoni koston aktuale të shërbimit për pjesën e mbetur të periudhës pas ndryshimit, kufizimit ose shlyerjes së planit, duke përdorur supozimet aktuale të përdorura për rivlerësimin e pasivitetit neto të përfitimit të definuar (aktive) që reflekton përfitimet e ofruara sipas planit dhe aktivitetit të planit pas asaj ngjarjeje
- Përcaktoni interesin neto për pjesën e mbetur të periudhës pas ndryshimit, kufizimit ose shlyerjes së planit duke përdorur: detyrimin neto të përfitimeve të përcaktuara (aktive) që pasqyrojnë përfitimet e ofruara sipas planit dhe aktiveve të skemës pas asaj ngjarjeje; dhe norma e skontimit të përdorur për të rimaturuar atë pasivitet neto të përfitimeve të përcaktuara (aktive).

Ndryshimet gjithashtu sqarojnë se një njësi ekonomike përcakton së pari çdo kosto të shërbimit të shkuar, ose një fitim ose humbje në shlyerje, pa marrë parasysh efektin e tavanit të aktivitetit. Kjo shumë njihet në fitim ose humbje. Një njësi ekonomike pastaj përcakton efektin e tavanit të aktivitetit pas ndryshimit, kufizimit ose shlyerjes së planit. Çdo ndryshim në këtë efekt, duke përjashtuar shumën e përfshirë në interesin neto, njihet në të ardhura e tjera gjithëpërfshirëse. Ndryshimet zbatohen për ndryshimet, kufizimet ose shlyerjen e planit që ndodhin në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1 janarit 2019, aplikimi i më hershëm është i lejuar. Këto ndryshime mund të zbatohen vetëm për çdo ndryshim, kufizime ose shlyerje të ardhshme të planit të Shoqërisë.

- **Ndryshimet në SNK 28: Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta**

Ndryshimet sqarojnë që një njësi ekonomike që zbaton SNRF 9 për interesat afatgjatë në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët në të cilën nuk aplikohet metoda e kapitalit neto, por që në thelb përbëjnë një pjesë të investimit neto në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët (afatgjatë interesat). Ky sqarim është i rëndësishëm sepse nënkupton që modeli i pritjes së humbjes së kredisë në SNRF 9 zbatohet për interesa të tilla afatgjata. Ndryshimet gjithashtu sqaruan se, në zbatimin e SNRF 9, një njësi ekonomike nuk merr parasysh humbjet e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, ose ndonjë humbje nga zhvlerësimi në investimet neto, të njohura si rregullime të investimit neto në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët që lindin nga zbatimi i SNK 28 Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta. Amendamentet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive dhe të jenë në fuqi nga 1 janari 2019, aplikimi i më hershëm është i lejuar. Meqenëse Shoqëria nuk ka interesa të tillë afatgjatë në shoqërinë e saj dhe sipërmarrjen e përbashkët, ndryshimet nuk do të kenë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

- **Përmirësime vjetore të SNRF-ve, Cikli 2015-2017 (leshuar ne Dhjetor 2017)**

Keto përmirësime përfshijnë:

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit**

Amendamentet sqarojnë se kur një njësi ekonomike merr kontrollin e një biznesi që është një operacion i përbashkët, ajo zbaton kërkesat për një kombinim biznesi të arritur në fazë, duke përfshirë rivlerësimin e interesave të mbajtura më parë në aktivitetet dhe pasivitetet e operacioneve të përbashkëta me vlerë të drejtë.

Duke vepruar kështu, blerësi e rimat të gjithë interesin e mbajtur më parë në operacionin e përbashkët. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në kombinimet e biznesit për të cilat data e blerjes është në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon më ose pas 1

Shënime të pasqyrat financiare (vazhdim)
Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

janarit 2019, aplikimi më hershëm është i lejueshëm. Këto ndryshime do të zbatohen për kombinimet e ardhshme të biznesit të Shoqërinë.

2.2 Standarte te emetuara por qe ende nuk kane hyre ne fuqi dhe nuk jane adoptuar (vazhdim)

- **SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta**

Një palë që merr pjesë, por nuk ka kontroll të përbashkët, një operacion i përbashkët mund të marrë kontroll të përbashkët të veprimtarisë e cila përbën një biznes siç përcaktohet në SNRF 3. Amendamentet sqarojnë se interesat e mbajtura më parë në atë operacion të përbashkët nuk rimaten. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në transaksionet në të cilat ajo fiton kontroll të përbashkët në ose pas fillimit të periudhës së parë të raportimit vjetor që fillon në ose pas 1 janarit 2019, aplikimi më hershëm është i lejueshëm. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Shoqërinë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

- **IAS 12 Income Taxes**

Amendamentet sqarojnë se pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve lidhen më drejtpërdrejt me transaksionet e mëparshme ose ngjarjet që gjenerojnë fitime të shpërndara sesa me shpërndarjet tek pronarët. Prandaj, njësi ekonomike njeh pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve në fitim ose humbje, të ardhura të tjera gjithëpërshiresë ose kapital sipas menyres se ku njësi ekonomike fillimisht i ka njohur ato transaksione ose ngjarje të mëparshme. Njësi ekonomike zbaton këto ndryshime për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, aplikimi më hershëm është i lejueshëm. Kur një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për here te pare, ajo i zbaton ato tek tatimi mbi të ardhurat i dividendëve të njohur në ose pas fillimit të periudhës më të hershme krahasuese. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Kompaninë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

- **SNK 23 Kostot e Huamarrjes**

Ndryshimet sqarojnë që një njësi ekonomike trajton si pjesë e huamarrjes së përgjithshme çdo huamarrje të bërë fillimisht për të zhvilluar një aktiv të kualifikuar kur në tërësi të gjitha aktivitetet e nevojshme për përgatitjen e atij aktivi për përdorimin ose shitjen e synuar janë të perfunduara. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime në kostot e huamarrjes të bëra në ose pas fillimit të periudhës raportuese vjetore në të cilën njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime. Një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë në ose pas 1 janarit 2019, aplikimi më hershëm është i lejueshëm. Këto ndryshime aktualisht nuk janë të zbatueshme për Kompaninë, por mund të zbatohen për transaksionet e ardhshme.

- **Ligji i Ri per Kontabilitetin ne Shqiperi**

Në vijim të punës që po bën qeveria shqiptare në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar më datë 10 maj 2018 ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (më poshtë “Ligji i ri për kontabilitetin” ose “Ligji i ri”), i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm nr. 9228, datë 29.4.2004.

Ligji i ri për kontabilitetin është përafuar pjesërisht me Direktivën 2013/34 të Bashkimit Evropian dhe qëllimi është përafrimi i plotë i tij në vitin 2028. Ligji I ri hyn në fuqi më datë 1 janar 2019. Aplikimi i Ligjit te ri nuk ka ndikim në pozicionin financiar dhe performancën e Shoqërisë dhe në menyren e pariqitjes se pasqyrave financiare.

Shoqëria ka zgjedhur te mos i implementoje keto standarde, rishikimeve dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Shoqëria parashikon qe adoptimi i ketyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do te kete ndikim material ne pasqyrat financiare te Entitetit ne periudhen e aplikimit fillestar.

Shënime të pasqyrat financiare (vazhdim)
Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

2.3 Vleresimet e rendesishme kontabel dhe supozimet

Në aplikimin e politikave kontabël të shoqërisë, që përshkruhen në Shënimin nr 2, nga drejtimi kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë të qarta nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuar në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen relevant. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet tek vlerësimet kontabël do të njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar nëq rishikimi afekton vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudha të ardhshme nëq rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe të ardhme.

Pasiguria në gjykime

Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Humbjet nga zhvlerësimi do të njihen në vlerën në të cilën vlera kontabël e aktiveve ose e njësisë gjeneruese te parase tejkalojnë vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson cmimet e pritshme dhe flukset e parase nga cdo njësi gjeneruese te parase dhe përcakton një normë interesi te përshtatshme kur kalkulohet vlera aktuale e këtyre flukseve parash.

Jeta e dobishme e aktiveve te amortizueshme

Drejtimi i Shoqërisë në mënyrë të rregullt analizon jetën e dobishme të aktiveve te amortizueshme në datën e pasqyrave financiare. Drejtimi vlerëson që jeta e dobishme e përcaktuar për aktivet paraqet dobishmerinë e pritshme të aktiveve. Vlera kontabel e këtyre aktiveve është analizuar në Shënimin 7. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve teknologjike.

3. Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile

18.1

Foreign currency transactions

Transaksionet në monedhe të huaj janë të konvertuara në leke dhe regjistrohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet monetare dhe zera të tjera jo monetare në monedhe të huaj rivelesohen në leke me kursin e këmbimit të Bankes së Shqipërisë në datën e fundit të periudhës raportuese. Diferencat e këmbimit valutë janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirë të Shoqërisë.

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhat kryesore për perktimin e zerave të pozicionit financiar të shprehur në monedhe të huaj paraqiten si vijon (në Leke):

1 EUR	31 Dhjetor 2018 123.42
-------	----------------------------------

18.2

Aktivët afatgjatë jo materiale

Aktivët afatgjatë jo materiale janë pasqyruar në librat e shoqërisë me koston e tyre historike minus zhvlerësimin e akumuluar.

Normat vjetore të zhvlerësimit të aplikuar janë si më poshtë:

	Normat e zhvlerësimit %	Bazë e llogaritjes
Aktivët afatgjatë jo materiale	2018	
Softwares	25	Vlera kontabël neto
Te tjera aktive jo-materiale	15	Vlera bruto

Vlera kontabël e aktiveve afatgjatë jo materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndryshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. N.q.s rrethana të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabël tejkalon vlerën neto të realizueshme, aktivet ose njësitë gjeneruese

Shënime të pasqyrat financiare (vazhdim)
Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

të parasë do të pakësohen në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shënime të pasqyrat financiare (vazhdim)
Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

18.3 Aktivet dhe detyrimet financiare

Shoqëria fillimisht njihet llogarite e arketueshme dhe depozitat monetare ne daten kur ato jane krijuar. Aktivet Financiare klasifikohen ne njohjen fillestar dhe maten me vlere me kosto te amortizueshme, me vlere te drejte nepermjet te ardhurat gjithepershires (OCI), dhe me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes. Te gjitha aktivet e tjera financiare (duke pershire aktivet e percaktuara me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes) njihen fillimisht ne daten e tregtimit ne te cilen Shoqëria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Shoqëria c'registron nje aktiv financiar kur te drejtat kontraktuale te flukseve te mjeteve monetare nga aktivi financiar mbarojne, ose kur transferon te drejtat per te marre flukse nga aktivi financiar ne nje transakcion ne te cilin kryesisht te gjitha rreziqet dhe perfitimet e pronese se aktivitet financiar jane transferuar. Cdo interes ne aktivet financiare te transferuara qe perfitohet ose mbahet nga Shoqëria eshte njohur si nje aktiv apo detyrim i vecante. Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet ne pasqyren e pozicionit financiar kur, dhe vetem kur, Shoqëria ka te drejte ligjore per te netuar shumat dhe synon ose te shlyeje mbi nje baze neto ose te realizoje aktivin dhe te shlyeje detyrimin ne te njejten kohe. Instrumentet financiare jo-derivative te Shoqërisë përfshijne llogarite e kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme, mjetet monetare, dhe furnitoret dhe detyrime te tjera.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijne parate e mbajtura ne bankat lokale ne monedhen vendase dhe te huaj dhe paraqiten me kosto

Furnitoret dhe detyrime te tjera

Furnitoret dhe detyrime te tjera jane pasqyruar fillimisht me vlere te drejte dhe me pas me koston e amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

18.4 Zhvleresimet

Aktivete financiare

Nje aktiv financiar qe nuk mbahet me vleren e drejte nepermjet fitimit ose humbjes, vleresohet ne cdo date raportimi per te percaktuar nese ka nje evidence objektive se ai eshte zhvleresuar. Shoqëria njihet një zhvleresim për humbjet e pritshme të kredisë (ECL) për të gjitha instrumentet e borxhit që nuk mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. ECL bazohen në diferencën ndërmjet flukseve monetare kontraktuale që duhet të paguhet në përputhje me kontratën dhe të gjitha flukse monetare që Shoqëria pret të marrë, te skontuara me një përaftrim të normës fillestare të interesit efektiv. Flukset monetare pritet të përfshijnë flukset e mjeteve monetare nga shitja e kolateralit të mbajtur ose te ardhura te tjera që janë pjesë përbërëse e kushteve kontraktuale. Humbja nga zhvleresimi i nje aktivi financiar te matur me koston e amortizuar eshte llogaritur si diferenca midis vleres kontabel dhe vleres aktuale te flukseve monetare te vleresuara te ardhshme te skontuara me normen fillestare te interesit efektiv te aktivitet. Humbjet njihen ne pasqyren e te ardhurave gjithepershires (fitim ose humbje) dhe pasqyrohen ne nje llogari zhvleresimi perkundrejt llogarive te arketueshme. Interesat mbi aktivet e zhvleresuara vazhdojne te njihen nepermjet skontimeve te pandryshueshme. Kur nje ngjarje pasuese ndikon ne uljen e shumes se zhvleresimit, renia ne humbjen nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave gjithepershires. Për të llogaritë e arkëtueshmet tregtare, Shoqëria zbaton një qasje të thjeshtuar në llogaritjen e ECLs. Si rrjedhojë, Shoqëria nuk ndjek ndryshimet në rrezikun e kredisë, por në vend të kësaj njihet një humbje nga zhvleresimi të bazuar në jetgjatësinë e ECL-ve në çdo datë raportimi. Shoqëria ka krijuar një matricë provizionesh që bazohet në përvojën e saj historike të humbjeve nga kreditimi, të përshtatur për faktorët e ardhshëm që janë specifike për debitorët dhe mjedisin ekonomik.

Aktivete jo-financiare

Vlerat kontabel e aktiveve jo-financiare te Shoqërisë rishikohet ne daten e raportimit per te percaktuar nese ka evidenca per zhvleresim. Nese ka evidenca te tilla, atehere vleresohet vlere e rikuperueshme e aktivitet. Shuma e rikuperueshme eshte me e madhja midis vleres se drejte minus koston per shitje dhe vlere ne perdorim. Ne vleresimin e vlere ne perdorim, flukset e ardhshme te mjeteve monetare jane skontuar ne vleren e tyre aktuale duke perdorur nje norme skontimi para taksave qe reflekton vleresimin aktual te tregut per vleren ne kohe te parase dhe rreziqet specifike per aktivin per te cilat vleresimet e flukseve monetare te ardhshme nuk jane rregulluar.

Shënime të pasqyrat financiare (vazhdim)
Per vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

Humbja nga zhvleresimi njihet nese vlera kontabel e nje aktivi ose e njesise gjeneruese te mjeteve monetare tejkalon vleren e rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave gjithepershiresë (ne fitim ose humbje).

18.5 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat perfshijne te ardhurat nga shitja e mallrave dhe kryerja e sherbimeve.

Te ardhurat maten duke ju referuar vleres se drejte te shumes se marre ose te arketueshme nga Shoqeria per mallrat e shitura dhe te sherbimeve te ofruara, duke perjashtuar taksat e shitjeve, rimbursimet, dhe skontot tregtare.

Shoqeria zbaton kriteret e njohjes se te ardhurave te percaktuara me poshte per secilin komponent te identifikueshem te transaksionit te shitjes per te reflektuar thelbin e transaksionit. Shuma e marre nga keto transaksione eshte ndare ne komponentin e vecante te identifikueshem duke marre parasysh vleren relative te drejtepercdo komponent.

Te ardhurat njihen kur shuma e te ardhurave mund te matet ne menyre te besueshme, mbledhja eshte e mundshme, shpenzimet e bera ose qe do te behen te mund te maten me besueshmeri, dhe kur kriteret per secilin nga aktivitetet e ndryshme te Shoqerise jane permbushur. Keto kriteret njohje sipas aktiviteve specifike jane te bazuara ne mallrat apo zgjidhjet e ofruara per konsumatorin dhe kushtet e kontrates ne cdo rast, dhe jane pershkruar me poshte:

Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhurat e interesit mbi fondet e investuara ne depozita bankare dhe fitimet ne valute te huaj.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzimet e interesit mbi huamarrjet, humbjet ne valute te huaj, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare me vlere te drejte nepermjet fitimit ose humbjes, dhe humbjet e njohura nga zhvleresimi i aktiveve financiare.

Fitimet dhe humbjet nga kembimi valutor raportohen ne baza neto.

18.6 Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin llogaritet ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar mbi Tatimin mbi Fitimin. Tatimi mbi fitimin njihet ne fitim ose humbje per sa kohe qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital ose ne te ardhura te tjera gjithepershiresë.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose substancialisht ne fuqi ne daten e raportimit, dhe cdo sistemim te tatimit te pagueshem per vitet e meparshme.

Tatimi aktual mbi fitimin eshte llogaritur me 15% (2017: 15%) te fitimit te tatueshem.

Tatimi i shtyre eshte njohur duke perdorur metoden e bilancit kontabel, nga diferencat e perkohshme ndermjet vleres kontabel te aktiveve dhe detyrimeve per qellime raportimi financiar dhe shumave te perdorura per qellime tatimi. Tatimi i shtyre eshte matur ne norma te tatimit qe pritet te aplikohen ndaj diferencave te perkohshme kur ato te ndryshojne, bazuar ne ligjet qe jane miratuar ose priten te miratohen ne daten e raportimit.

Nje aktiv tatimor i shtyre njihet per sa kohe eshte e mundur qe fitimi i tatueshem i ardhshem te jete ne dispozicion kundrejt te cilit mund te perdoret ndryshim i perkohshem. Aktivitetet e tatimit te shtyre (nese ka) jane rishikuar ne secilen date te raportimit dhe jane reduktuar deri ne masen ku nuk eshte e mundur qe perfitimet nga tatimi do te realizohen.

Shënime të pasqyrat financiare (vazhdim)
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

18.7 Perfitimet pas-daljes ne pension dhe planet e pensioneve

Shoqeria kryen vetem kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore qe ofrojne punonjesve perfitime pas daljes ne pension. Qeveria e Shqiperise eshte pergjegjese per percaktimin e limitit minimal ligjor te vendosur per pensionet ne Shqiperi sipas nje plani kontributesh pensioni te percaktuar. Kontributet e shoqerise ndaj planit te pensioneve jane ngarkuar ne fitim ose humbje ne momentin kur ndodhin.

18.8 Kapitali

Kapitali aksioner perbehet prej mjeteve monetare te kontribuar nga themeluesit e shoqerise. Kapitali aksioner mbahet ne shumen e konvertuar leke te monedhes se huaj te marre, duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit.

18.9 Provigjonet

Nje provigjon njihet kur Shoqeria ka nje detyrim aktual si rezultat i ngjarjeve te meparshme dhe eshte e mundur qe te kete nje dalje te burimeve qe perfaqesojne perfitimet ekonomike per te shlyer detyrimin, dhe mund te behet nje vleresim i besueshem i shumes se detyrimit. Provigjonet rishikohen ne cdo date te pozicionit financiar dhe rregullohen per te reflektuar vleresimin me te mire aktual. Kur efekti i vleres ne kohe te parase eshte material, shuma e provigjonit eshte vlere aktuale e shpenzimeve te pritshme te nevojshme per shlyerjen e detyrimit. Provigjonet nuk njihen per humbjet e ardhshme operative.

18.10 Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen ne shenimet shpjeguese pervec rasteve kur mundesia e nje dalje te burimeve qe perfshijne perfitime ekonomike eshte shume e ulet. Nje aktiv i kushtezuar nuk njihet ne pasqyrat financiare por eshte pasqyruar ne shenimet shpjeguese kur hyrja e perfitimeve ekonomike eshte e mundshme. Shuma e humbjes se kushtezuar eshte njohur si provigjon nese eshte e mundshme qe ngjarjet e ardhshme do te konfirmohen dhe se mund te behet nje vleresim i arsyeshem i shumes se humbjes ne daten e pozicionit financiar.

18.11 Transaksionet e paleve te lidhura

Palet e lidhura jane ato ku njera nga palet eshte e kontrolluar nga tjetra, ose ka ndikim te rendesishem ne marrjen e vendimeve financiare apo te biznesit te pales tjetere.

18.12 Ngjarje pas periudhes se raportimit

Ngjarjet pas perfundimit te vitit te cilat japin informacione shtese per poziten e shoqerise ne daten e pozicionit financiar (ngjarjet rregulluese) jane reflektuar ne pasqyrat financiare. Ngjarjet pas perfundimit te vitit qe nuk jane ngjarje rregulluese jane pasqyruar ne shenime kur jane materiale.

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2018
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

4. Mjetet monetare dhe ekuivalente

Mjetet monetare dhe ekuivalente janë analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018
<u>Arka</u>	
- në monedhë vendase	-
	-
<u>Llogari rrjedhëse ne banka</u>	
- në monedhe vendase	6,448,000
- në monedhë të huaj	-
	6,448,000
Totali i mjeteve monetare dhe ekuivalente	6,448,000

5. Të tjera të drejta të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë detajuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018
TVSH e arkëtueshme	30,163
Totali	30,163

6. Aktivët afatgjata jomateriale

	Pajisje Informatike	Total
Kosto		
Më 1 Janar 2018	-	-
Shtesa	11,417,996	11,417,996
Më 31 Dhjetor 2018	11,417,996	11,417,996
Amortizimi		
Më 1 Januar 2018	-	-
Amortizimi i vitit	-	-
Më 31 Dhjetor 2018	-	-
Vlera Neto Kontabël më 01 Janar 2018	-	-
Vlera Neto Kontabël më 31 Dhjetor 2018	11,417,996	11,417,996

Aktivët afatgjata jomateriale nuk janë amortizuar pasi nuk janë ende gati për përdorim.

7. Furnitorë

Furnitorët përfshijnë detyrimet kundrejt furnitorëve të huaj dhe vendas. Balancat e furnitorëve janë analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018
Furnitore vendas	180,687
Furnitore te huaj	11,453,376
Total	11,634,063

Furnitorët nuk mbartin interes.

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2018
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

8. Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të pagueshme

Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të pagueshme, i përkasin muajit nëntor dhe dhjetor 2018.

	31 Dhjetor 2018
Paga të pagueshme	-
Sigurime shoqërore e shëndetësore	21,305
Totali	21,305

Sigurimet shoqërore e shëndetësore shlyhen jo më vonë se 20 ditë pas mbylljes së tremujorit.

9. Të tjera të pagueshme

	31 Dhjetor 2018
Detyrime për taksat lokale	3,500
Totali	3,500

10. Provigjone

Shoqëria nuk kishte provigjone apo detyrime të kushtezuara për të shpalosur apo regjistruar në pasqyrat financiare në fund të vitit

11. Detyrime afatgjata

Shoqëria nuk kishte detyrime afatgjata për të regjistruar në pasqyrat financiare në fund të vitit

12. Kapitali dhe rezervat

Kapitali

Më 31 Dhjetor 2018, sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) totali i kapitalit të regjistruar është 6,300,000 Lekë.

Më poshtë është struktura e kapitalit më 31 Dhjetor 2018:

	2018	%
Medsympan Limited LTD	6,300,000	100%
Totali	6,300,000	100%

13. Shitje e shërbimeve

Shoqëria gjatë vitit 2018 nuk kishte aktivitet, të ardhurat nga shitja e të mirave dhe shërbimeve janë për vitin e mbyllur 2018 janë zero.

14. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	21,305
Totali	21,305

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2018
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

15. Shpenzime administrative dhe të tjera

Shpenzimet administrative dhe të tjera operative përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2018
Shërbim konsulence	89,006
Shërbime kontabiliteti dhe taksash	61,810
Taksat vendore	3,500
Total	154,316

16. Të ardhurat (shpenzimet) financiare, neto

Të ardhurat/(shpenzimet) financiare përfshijnë fitimet dhe humbjet e realizuara apo të porealizuara nga kurset e këmbimit si vijon:

	31 Dhjetor 2018
Fitim nga kurset e këmbimit	148,000
(Humbje) nga kurset e këmbimit	-35,087
Fitim /(Humbje) neto nga kurset e këmbimit	112,913
Totali të ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	112,913

17. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatim fitimit për vitin 2018 i llogaritur si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018
1 Fitimi/(Humbja) para tatimit	-62,709
2 Shpenzime të pazbritshme	-
3 Penalitete, gjoba	-
4 Fitimi / (humbje) e tatueshme (1+2+3)	-62,709
7 Norma e tatimit mbi fitimin	0%
8 Shpenzim tatim fitimi	-
9 Tatim fitimi I parapaguar	-
10 Tatim fitimi i arketueshem (i pagueshem)	-

18. Manaxhimi i Riskut Financiar

18.1 Faktoret e riskut financiar

Aktivitetet e Shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj rreziqeve financiare, duke përfshirë riskun e kredise dhe risqet që lidhen me efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të Shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi ecurinë e biznesit të shoqërisë.

Menaxhimi i riskut kryhet nga Drejtimi bazuar në politikat dhe procedurat që mbulojnë menaxhimin e riskut të përgjithshëm, si dhe tipe të vecanta, të tilla si risku nga kursi i këmbimit, risku i normës së interesit, risku i kredise, përdorimi i letrave me vlerë të pershtatshme dhe investimi i likuiditetit të tepert.

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2018
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

18.2 Risku i tregut

Risku i kursit të kembimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të kembimit që vjen nga kembimet në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me Euro dhe USD. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për të mbrojtur nga risku i kembimit valutës. Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur një gjendje të duhur neto në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e perdritshme.

Aktivitetet dhe detyrimet e Shoqërisë në valute të huaja më 31 dhjetor 2018, janë si më poshtë:

Aktivitetet financiare		2018	
		ALL	
EUR			-
USD			-
<hr/>		<hr/>	
Detyrimet financiare			
EUR		11,634,063	
USD			-
<hr/>		<hr/>	
		11,634,063	
Analiza e ndjeshmerisë ndaj kursit të kembimit			
			2018
	Net exposure	10%	-10%
EUR	-11,634,063	-1,163,406	1,163,406
<hr/>			<hr/>
Fitim (humbje) nga kembimi valutës			-1,163,406 1,163,406
	Net exposure	10%	-10%
USD	-	-	-
<hr/>			<hr/>
Fitim (humbje) nga kembimi valutës			- -

Analiza e ndjeshmerisë përfshin vetëm artikujt monetarë të shprehura në monedhë të huaja në fund të vitit, dhe gjithashtu është bërë një korrigjim i vlerës së tyre për një ndryshim 10% në normat në valute të huaja. Shuma pozitive/negative tregon rritjen/renien në fitim ose kapital, e cila ndodh kur LEK dobësohet/forcohet kundrejt monedhave të huaja me +/- 10%.

Risku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e drejtë ose flukset monetarë të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të ndryshimeve në normat e interesit të tregut ka të bëjë kryesisht me detyrimet afatgjata të qirase financiare të Shoqërisë me norma të interesit të ndryshueshme. Nuk ka përqendrim të fondesh të marra hua me interes të ndryshueshem nga institucionet financiare ose subjektet e tjera në datën e raportimit. Në të njëjtën kohë, shoqëria nuk ka vendosje të materialeve të aseteve të saj në depozita me afat dhe letrave me vlerë likuide, që kanë të ardhura shtesë të interesit.

Tabela e mëposhtme tregon sensitivitetin ndaj një ndryshimi të arsyeshëm të mundshëm në normat e interesit në atë pjesë të kredive (qirase financiare) të prekur. Me të gjithë variablat e tjerë të mbajtur të pandryshuar, fitimi i shoqërisë para tatimit është prekur nga ndikimi i normave të ndryshueshme të interesit, si më poshtë:

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2018
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

	2018
Aktive financiare	
<i>Qe nuk mbartin interes:</i>	
Llogari te arketueshme	-
Llogari te arketueshme dhe te tjera	-
	-
<i>Qe mbartin interes fiks:</i>	
Paraja dhe ekuivalentet e saj	6,448,000
	6,448,000
	6,448,000
Detyrime financiare	
<i>Qe nuk mbartin interes:</i>	
Llogari te pagueshme	11,634,063
Detyrime te tjera	21,305
	11,655,368
<i>Qe mbartin interes variabel:</i>	
Detyrime per hua	-
	-
	11,655,368
	2018
	Shuma neto
	2%
Me norme interesi variable	-2%
	-

Vlera pozitive/negative tregon rritje/renie ne fitim ose ne kapital qe ndodhin kur normat e interesit jane rritur / ulur me 2%.

18.3 Risku i kreditit

Shoqeria nuk ka risk te rendesishme te kreditit. Shoqeria ka politika per te siguruar qe shitjet e produkteve te behen per klientet me nje historik krediti te pershtatshem. Shoqeria ka politika qe kufizojne sasine e ekspozimit riskut te kreditit per cilindo klient. Risqet e njohura rregjistrohen si provigjone mbi llogarite e arketueshme.

Gjithashtu, risku i kreditit qe vjen nga aktivet e tjera financiare te Shoqerise, te cilat perfshijne mjetet monetare dhe huamarrjen e arketueshme afatshkurter, lind nga vonesa ne pagesa te pales tjetere, me nje ekspozim maksimal te barabarte me vleren kontabel i ketyre instrumenteve

	2018
Vlerat e klasave te aktiveve financiare:	
Mjetet monetare	6,448,000
Llogari dhe kerkesa te arketueshme dhe te tjera te arketueshme	-
Totali	6,448,000

18.4 Risku i likuiditetit

Shoqeria menaxhon nevojat e saj per likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e planifikuara per detyrimet afatgjata financiare si dhe te parashikojne flukset monetare gjate aktiviteteteve te perditshme. Nevojat per likuiditet jane te monitoruara ne grupe te ndryshme kohore. Kerkesa neto per mjete monetare eshte krahasuar me provigjonet per huamarrje ne dispozicion ne menyre qe te percaktohet ndonje mungese. Kjo analize tregon nese provigjonet e huamarrjes ne dispozicion pritet te jene te mjaftueshme gjate periudhes ne fjale. Shoqeria mban mjete monetare per te permbushur kerkesat e likuiditetit per periudha minimum 30-ditore. Financimi per nevoja likuiditeti afat-gjateeshte siguruar gjithashtu nga nje sasi e mjaftueshme te provigjoneve te kreditit te ndermarra.

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2018
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

Me 31 dhjetor 2018, detyrimet e shoqërisë kanë maturime kontraktuale (duke përfshirë pagesat e interesit aty ku është e aplikueshme), të përmbledhura si më poshtë:

Me 31 dhjetor 2017	Afatshkurter	Afatgjate	
	1 deri 12 muaj	1 deri 5 vjet	Me shume se 5 vjet
Llogari e kërkesa të pagueshme	11,634,063	-	-
Sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore të pagueshme	21,305	-	-
Detyrime të tjera	3,500	-	-
	11,658,868	-	-

Vlerat më sipër janë të barabarta me detyrimet kontraktuale të paskontuara të cilat mund të jenë të ndryshme nga vlera kontabel e detyrimeve në datën e raportimit.

18.5 Menaxhimi i riskut të kapitalit

Objektivat kryesorë të Shoqërisë në menaxhimin e kapitalit janë ruajtja e aftësisë së Shoqërisë për të ofruar në mënyrë të vazhdueshme të ardhura për aksionerët dhe përfitime për investitorët e tjerë dhe të ruajtjeve një struktura kapitali optimale për të reduktuar koston e kapitalit.

Në mënyrë që të ruhet dhe rregullohet struktura e kapitalit, Shoqëria mund të rregullojë shumën e dividendëve të paguar aksionerëve, kthejë kapital aksionerëve, emetojë aksione të reja ose të shesë aktive për të reduktuar borxhin.

Gearing ratio (Raporti Borxh/Kapital)

Struktura e kapitalit të Shoqërisë, përfshin detyrimet, mjetet monetare dhe kapitalin, i cili përfshin kapitalin aksioner dhe fitimin e pashpërndarë ose humbjet e akumuluar. Drejtimi rishikon strukturën e kapitalit në bazë vjetore si një lidhje midis detyrimeve neto të kredive dhe kapitalit total. Detyrimet neto të kredive llogariten si një diferencë midis detyrimeve totale për huamarrje me vlerën e mjeteve monetare.

Treguesi i borxhit në fund të vitit është si më poshtë:

	2018
Huamarrje me interes	-
Llogari e kërkesa të pagueshme dhe detyrime të tjera	11,658,868
Mjete monetare	-6,448,000
Detyrime neto	5,210,868
Kapitali	6,237,291
Gearing ratio (Raporti Borxh/Kapital)	0.84

19. Vleresimi me vlerë të drejte

Vlera e drejte përfaqëson vlerën me të cilën një aktiv mund të zëvendësohet ose një detyrim të shlyhet në kushte të tregut. Vlera e drejte është bazuar në supozimin e drejtimit në përputhje me profilin e aktivitetit dhe bazën e detyrimit.

19.1 Financial instruments presented at fair value

Aktivet financiare të matura me vlerë të drejte janë në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejte e cila i grupon aktivet dhe detyrimet financiare në tre nivele bazuar në rëndësinë e të dhenave të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejte të aktiveve financiare. Hierarkia e vlerës së drejte është si vijon:

- **Niveli 1:** cmimet e kuotuar (të pakorigjuara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime financiare të ngjashme;

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2018
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

- **Niveli 2:** te dhena te tjera pervec cmimeve te kuotuar te perfshira ne Nivelin 1 qe jane te disponueshme per aktivet dhe detyrimet te observuar, direkt (psh cmimet) ose indirekt (te dhena nga cmimet) dhe
- **Niveli 3:** te dhena mbi aktivet dhe detyrimet qe nuk jane te bazuar ne te dhena te disponueshme nga observimi i tregut

Me 31 dhjetor 2018, vlera e aktiveve dhe detyrimeve financiare te Shoqerise ne perputhje me klasifikimin e tyre eshte percaktuar duke perdorur koston e amortizuar.

19.2 Instrumentat financiare te cilat nuk jane prezantuar me vlera te drejte

Me poshte, nje krahasim, sipas klasave, i vlerave te mbartura dhe vlerave te drejta te instrumentave financiare te Shoqerise sic jane pasqyruar ne pasqyrat financiare.

	Vlera e mbartur 2018	Vlera e drejte 2018
Aktivet		
Mjete monetare	6,448,000	6,448,000
Llogari dhe kerkesa te arketueshme	-	-
Totali i aktiveve	6,448,000	6,448,000
Detyrimet		
Llogari e kerkesa te pagueshme	11,634,063	11,634,063
Detyrime te tjera	24,805	24,805
Totali i detyrimeve	11,658,868	11,658,868

Mjetet monetare

Vlera e drejte e aktiveve monetare qe perfshijne mjetet monetare, konsiderohet si e perafert me vleren e tyre te mbartur si rezultat i maturimit te tyre me te vogel se 3 muaj.

Furnitore dhe detyrime te tjera

Vlera e mbartur e furnitoreve dhe kredive te pagueshme perafron vleren e tyre te drejte.

19.3 Instrumenta financiare sipas kategorise

Vlerat kontabel te aktiveve dhe detyrimeve financiare te Kompanise sic paraqiten ne daten e pasqyres se pozicionit financiar per periudhat raportuese nen rishikim mund te kategorizohen si vijon:

31 dhjetor 2018	Instrumente borxhi me kosot te amortizueshme	Aktive me vlera te drejte nepermjet fitim humbjes	Instrumente borxhi/ Aktive me vlera te drejte OCI	Totali
Aktivet sipas pasqyres se pozicionit financiar				
Llogari te arketueshme dhe te tjera	-	-	-	-
Aktivet monetare dhe ekuivalentet e tyre	6,448,000	-	-	6,448,000
	6,448,000	-	-	6,448,000
Detyrimet sipas pasqyres se pozicionit financiar				
Llogari te pagueshme dhe detyrime te tjera		-	11,658,868	11,658,868
		-	11,658,868	11,658,868

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2018
Të gjitha shumat janë shprehur në LEK

20. Tranaksione me pale te lidhura

Shoqëria nuk ka pasur transaksione me palet e lidhura gjate kursit te saj normal te aktiviteteve te biznesit.

21. Angazhime dhe detyrime te kushtezuara

Angazhime

Shoqëria nuk ka angazhime materiale të nënkontraktuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat të mos jenë reflektuar në pasqyrat financiare.

Detyrime tatimore

Librat dhe të dhënat kontabël për vitet financiare që përfundojnë më 31 Dhjetor 2018 nuk janë audituar nga autoritetet tatimore. Si rrjedhim, detyrimet tatimore të Shoqërisë mund të mos konsiderohen të finalizuara. Detyrime tatimore shtesë që mund të lindin në rast të auditimit të autoriteteve tatimore nuk mund të percaktohen me saktësi.

Çështje ligjore

Më 31 Dhjetor 2018 nuk ka çështje gjyqësore të ngritura kundër shoqërisë ose nga shoqëria.

22. Ngjarje pas datës së raportimit

Mbas datës 31 Dhjetor 2018 – datë e raportimit dhe e aprovimit të pasqyrave financiare, nuk ka ngjarje materialisht të rëndësishme që të mund të ndikojnë në këto pasqyra financiare.



Deklarata e hartuesit të pasqyrave financiare

Për Ortakun dhe Drejtimin e

Coral Albania Sha (referuar më poshte si “shoqëria”).

Ne kemi hartuar pasqyrat financiare të shoqërisë në bazë të dokumenteve që ju na keni ofruar. Këto pasqyra financiare përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të shoqërisë më 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Para hartimit të pasqyrave financiare të shoqërisë, TPA Albania shpk kreu shërbimet e kontabilitetit të cilat përfshinin regjistrimin e veprimeve kontabël dhe përgatitjen e bilancit verifikues.


Ne kemi aplikuar ekspertizën tonë në kontabilitetin dhe raportim financiar për t’ju ndihmuar në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”). Ne kemi qenë në përputhje me kërkesat etike relevante, duke përfshirë edhe parimet e integritetit, objektivitetit, kompetencën profesionale dhe kujdesin e duhur.

Këto pasqyra financiare, saktësia dhe plotësia e dokumenteve dhe informacionit të përdorura për të përpiluar ato janë përgjegjësia juaj. Përgjegjësia jonë është të hartojmë pasqyrat financiare në përputhje me, ligjin Nr 9228 date 29 Prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin Nr 9477 datë 09.02.2006 dhe me urdhrin e Ministrit të Financave Nr 65 date 05.05.2008.

Meqenëse shërbimi i hartimit të pasqyrave financiare nuk është një shërbim sigurie, ne nuk jemi të detyruar të verifikojmë plotësinë e dokumenteve që ju na keni ofruar për hartimin e këtyre pasqyrave financiare. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion auditimi ose një konkluzion nëse këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

Pasqyrat financiare të kompanisë janë përgatitur në gjuhën Angleze dhe përkthyer në gjuhën Shqipe. Versioni në gjuhën Angleze do të jetë versioni relevant ligjor dhe do të ketë përparësi ligjore në rast të ndonjë mospërputhje midis tekstit në Anglisht dhe përkthimit në ndonjë gjuhë tjetër.

Tiranë,
23 Mars 2019


Ilir Binaj CPA, CGMA
EKR Lic. Nr.205 datë 04.10.2010

